



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 19

Prishtinë, më 21.05.2015, në ora 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Ilir Deda, Time Kadrijaj, Vjosa Osmani, Valdete Bajrami, Luljeta Veselaj- Gutaj dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Xhavit Haliti, Rustem Mustafa, Arben Gashi dhe Sllobodan Petroviq.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Përgjimin e Telekomunikimeve;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Përgjimin e Telekomunikimeve

Kryetarja e hapi takimin dhe i njoftoi se lidhur me këtë projektligj grupi punues, i kryesuar nga deputeti Ilir Deda, kanë punuar dy ditë me radhë dhe kanë nxjerrë raportin me amendamente. Në vazhdim ia dha fjalën kryesuesit të grupit punues.

Ilir Deda -I njoftoi se pas miratimit në parim të projektligjit më 18 maj 2015, Grupi Punues më 19 maj 2015, ka mbajtur takim me përfaqësuesit e Institucioneve dhe OJQ-ve. Në këtë takim kanë marrë pjesë përfaqësues nga:

Prokuroria Speciale e Kosovës, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ASHMDHP), Policisë së Kosovës, Zyra e BE-së, Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, Institutit GAP, Grupit për Studime Juridike dhe Politike, DCAF dhe OSBE.

Kanë qenë të ftuar, por nuk kanë marrë pjesë, përfaqësues nga Ministrisë së Integritimit Evropian-sponsorizues i Projektligjit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, AKI-së, Këshillit Prokurorial të Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Komisionit për punë të Brendshme dhe Komisionit për mbikëqyrje të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës.

Në këtë takim kemi bërë shqyrtimin e projektligjit nen për nen, ku kemi inkorporuar vërejtjet dhe propozimet konkrete.

Po ashtu më 20 maj 2015, Grupi Punues ka mbajtur takim dhe jemi pajtuar për raportin me 17 amendamentet e propozuara si vijon:

Amendamenti 1

Neni 1, paragrafi 4 të fshihet.

Amendamenti 2

Neni 3, nënparagrafi 1.3. definicioni “**përgjim i komunikimeve elektronike**”, zëvendësohet me “**përgjim i telekomunikimeve**”.

Amendamenti 3

Neni 3, nënparagrafi 1.9. në rreshtin e dytë fshihen fjalët “**e Policisë së Kosovës**”.

Amendamenti 4

Neni 3, pas nënparagrafit 1.9. shtohet nënparagraf i ri:

“1.10. “Minimizim sipas urdhrit gjyqësor” nënkupton procesin teknik sipas të cilit zyrtari i autorizuar sipas urdhrit gjyqësor filtron të dhënat e marra gjatë përgjimit që nuk janë objekt i hetimit.

Në vijim bëhet rirenditja e nënparagrafëve.

Amendamenti 5

Neni 5, nënparagrafi 1.2, riformulohet si vijon: “**Përgjimi për nevojat e sigurisë së Kosovës**”

Amendamenti 6

Neni 8, paragrafi 2, emërtimi “**Inspektorati Policor**” zëvendësohet me emërtimin “**Inspektoratin Policor të Kosovës**”.

Amendamenti 7

Neni 10, paragrafi 2 fjalët “**mund të jetë edhe**” zëvendësohet me fjalën “**është**”.

Amendamenti 8

Neni 11, pas paragrafit 3 shtohet paragraf i ri:

4. “Gjatë zbatimit të urdhrit për përgjim zyrtari i autorizuar me urdhër gjyqësor është i obliguar për minimizimin e bisedave gjatë përgjimit”.

Amendamenti 9

Teksti “**Kapitulli - IV sistemi i përgjimit**” fshihet, kurse nenet mbesin si në projektligj.

Amendamenti 10

Neni 16, fjala “**Njësitë**” zëvendësohet me fjalën “**Njësia**”.

Amendamenti 11

Neni 18, nënparagrafi 3.2 fshihet, kurse nënparagrafi 3.3 bëhet 3.2.

Amendamenti 12

Neni 26, fshihet në tërësi, kurse në vijim të projektligjit bëhet rirenditja e të gjitha neneve.

Amendamenti 13

Neni 29, paragrafi 2 fjalët “**Policisë së Kosovës**” zëvendësohet me fjalët “**Agjencisë Kosovare të Inteligjencës**”.

Amendamenti 14

Neni 32, paragrafi 2 fjalët “**dhe Prokurorit të Shtetit**” zëvendësohet me fjalët “**Prokurorit të Shtetit dhe komisioneve përkatëse parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës**”.

Amendamenti 15

Neni 33, fjala “**i raporton**” zëvendësohet me fjalët “**është në vartësi të**”.

Amendamenti 16

Neni 34, pas paragrafit 11 shtohet paragraf i ri, si vijon: “**12. Konkluzionet e Komisionarit nuk ndikojnë në procedurën e ankesës individuale pranë Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ASHMDHP)**”.

Amendamenti 17

Neni 35, në fund të tekstit pas fjalës **Komisionarit** shtohet teksti “**më së largu 3 (tre) muaj**”.

Kryetarja propozoi që të shkohet në shqyrtim nen për nen.

Ajo fillimisht kishte vërejtje në titullin e ligjit dhe lidhur me këtë propozoi që të ndërrohet në Ligjin për përgjimin e komunikimeve elektronike, sepse telekomunikimet elektronike paraqesin një komunikim më të gjerë se telekomunikimet, sepse gjatë viteve komunikimet janë pasuruar edhe me lloje të tjera, përveç komunikimeve me telefon dhe komplet ligji i lejon edhe telekomunikimet e tjera, andaj propozoj që edhe emërtimi i ligjit të jetë kompaktibil me përmbajtjen e Ligjit. Substanca e ligjit i mundëson përgjimet edhe të emajlave dhe mënyrave tjera të komunikimit elektronik.

Komisioni miratoi propozimin dhe titulli i projektligjit u riformulua në **Ligjin për përgjimin e Komunikimeve elektronike** u shtua amendamenti dhe u ndërrua renditja dhe u bë amendamenti 1.

Kryetarja vazhdoi me amendamentet e propozuara nga grupi punues dhe kaloi në amendamentin 1 i cili u miratua.

Amendamenti 2. nuk u miratua, mbeti si në Projektligj, **amendamenti 3,** u miratua. Lidhur me amendamenti 4 në të cilin në nenin 3, pas nënparagrafit 1.9 është shtuar paragrafi i ri z. Deda sqaroi pse është shtuar ky amendament. Ai tha se çdo përgjim duhet të filtrohet që të jetë i tillë dhe të jetë relevant vetëm për hetime, këtë e thanë prokuroria dhe policia dhe të gjitha institucionet që merren me këtë fushë, u dakorduan që pa tjetër të bëhet dhe jo të nënkuptohet që është punë e tillë. **Amendamenti 4** u miratua nga Komisioni.

Lidhur me amendamentin 5, që ka të bëjë me nenin 5, nënparagrafin 1.2 për të cilin grupi punues ka hartuar një amendament z. Deda i njoftoi se lidhur me këtë nen kanë ardhur dy propozime për amendamente, nga deputeti Nait Hasani dhe deputeti Bekim Haxhiu, por që janë të ngjashme me propozimin e grupit punues. Grupi punues e ka konsideruar si më të saktë amendamentin e vet, andaj këto dy propozime të këtyre dy deputetëve nuk u përkrahën.

Komisioni nuk i miratoi amendamentet e deputetit Nait Hasani dhe Bekim Haxhiut, por e miratoi **amendamentin numër 5** të grupit punues.

Amendamenti 6 dhe amendamenti 7 u miratuan pa ndryshime.

Lidhur me **amendamentin 8** që ka të bëjë me nenin 11, që pas paragrafit 3 të shtohet paragraf i ri, kishte propozime që të ndryshohet.

Komisioni pas diskutimeve vendosi që ta ndryshojë këtë amendament, vendosi të hiqen fjalët minimizimi i bisedave dhe të zëvendësohet „**minimizim i përgjimit**”.

Amendamenti 8 u miratua me këtë ndryshim.

Amendamenti 9 , amendamenti 10 dhe amendamenti 11 u miratuan pa ndryshime.

Amendamenti 12, në grupin punues është vendosur që neni 26 të fshihet në tërësi, por pas diskutimeve Komisioni vendosi që ky nen të mos fshihet, andaj **amendamenti 12** nuk u miratua.

Ilir Deda para amendamentit 13 tha se kishte dilema te neni 28, që ka të bëjë me shkatërrimin e të dhënave, në ligj afati është 12 muaj për shkatërrimin e të dhënave, e konsideron se duhet me u shkurtuar afati. Pas diskutimeve Komisioni vendosi që afati prej 12 muajve të zëvendësohet **me 9 muaj.** Ky ndryshim u miratua dhe u bë amendament i ri.

Amendamentet 13 dhe 14 u miratuan pa ndryshime.

Pasi komisioni nuk kishte kuorum për ta vazhduar punën, kryetarja vendosi që të vazhdohet në ditën e nesërme prej orës 11.

Mbledhja përfundoi në orën 9:30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit,

Znj.Teuta Sahatqija